



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërim i Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione /10 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Të formojë një gjykim personal, racional dhe aktiv mbi momentet thelbësore të kulturës italiane. Të dijë si të analizojë në mënyrë kritike proceset e historisë italiane në periudhën e referimit. Të njohë proceset historike; të bëjë lidhje midis fakteve shoqërore, historisë së artit dhe kulturës dhe rolit të luajtur nga individë të veçantë

Objektivat specifike lëndore :

Studenti duhet:

1. Të dijë të njohë, të analizojë dhe të interpretojë veprat artistike të periudhës referuese në fushën e arteve figurative.
2. Të dijë të bëjë përshkrime analitike të veprave artistike të trajtuara gjatë kursit
3. Të dijë si të krahasojë fenomenet, punimet dhe autorët duke kapur veçoritë, ndryshimet dhe tiparet e përbashkëta

Rezultatet e pritshme: Studentët në fund të kursit duhet të kenë njohuri të mira të gjuhës italiane dhe duhet të kenë një përgatitje të mëparshme të përgjithshme mbi historinë e Italisë. Aftësi për të ushtruar të menduarit analitik, interpretimin kritik dhe logjik të fenomeneve të ndryshme. Aftësi për të zhvilluar kompetencat e prezantimit analitik dhe argumentimit rreth temave të propozuara